We would be very happy if you are able to attend this event, and also to join the opening ceremony, on 9th February 2009. The expenses should be down by the institutions supporting this project.

For further information please do not hesitate to contact me.

Yours sincerely,

FACULTAD DE FILOLOGÍA
DEPARTAMENTO DE FILOLOGÍA
ROMÁNICA, FILOLOGÍA ESLAVA Y
LINGÜÍSTICA GENERAL

Dr. Sc. Francisco Javier Juez Gálvez
Project Coordinator in the
Universidad Complutense

Nansen Dialogue Mitrovica

HØJSKOLEN ØSTERSØEN

# *Certificate*

## **Tafil Peci**

has participated in

**Danish-German borderland and ethnic divide in Kosovo**

An eleven-day seminar at Højskolen Østersøen

With financial support from:

*Norwegian Foreign Ministry*

*Swiss Office in Pristina*

*European Centre for Minority Issues*

in Aabenraa, April the $30^{th}$ – May the $10^{th}$, 2003

**Steinar Bryn**
*Nansenskolen, Lillehammer*

**Dan Smith**
*International Peace Research Institute, Oslo*

**Jesper Nielsen**
*Højskolen Østersøen, Aabenraa*

ECDL Foundation

ECDL Kosova

This is to certify that

# Tafil Peci

has successfully passed the following module(s)

**M3: Word Processing**
**M6: Presentation**
**M4: Spreadsheets**
**M1: Information and Communication Technology**

Required for the granting of the ECDL Start, Syllabus Version 5.0

These modules are developed by ECDL Foundation and awarded in Kosova by ECDL Kosova SH.A.
For more details on each module visit www.ecdl-kosova.org or www.ecdl.org

| ECDL [illegible] | 07.09.2010 | XP-0007722 MASHT - AUK |
|---|---|---|
| | Date | Skills Card Number |

DREJTORIA
KOMUNALE E
ARSIMIT
MITROVICË

# MIRËNJOHJE

## TAFIL PECI

Për kontributin e dhënë në procesin edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2010/11

17 Qershor 2011,

Mitrovicë

Drejtori i Drejtorisë

Mr. Ali BEJTA

**SHKOLLA E MESME E ULËT**
**"GJERGJ KASTRIOTI - SKENDERBEU"**



ndanë këtë

# MIRËNJOHJE

**z.** *Tafil Peci*

*Për arritjen e suksesit në mësimdhënie në pikturë*

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MITROVICËS
Shkolla e Mesme e Ulët
"GJ. K. SKËNDERBEU"
MITROVICË
Niža Srednja Škola
OPŠTINA MITROVICA
REPUBLIKA KOSOVO

Xhelal Tahiri
Drejtor i shkollës

Mitrovicë, 28.11.2011

**SHKOLLA FILLORE**
**E MESME E ULTË**
**"Gj.K.Skenderbeu"**
**Mitrovicë**



**Ndanë këtë:**

# *MIRËNJOHJE*

Për: **mësimdhënësin**

## z.Tafil Peci

Për arritjen e rezultateve në gara komunale,
vendin e parë në art.

Mitrovicë
28.11.2012

Drejtori i shkollës:
Xhelal Tahiri



Ekspozitë



# Ekspozitë e Gani Sadikut dhe Tafil Pecit - Tafës

## Në "Liburnën" buzë Lumit të Bardhë u vlerësuan lartë punimet e krijuesve të rinj nga Qyteti i Minatorëve




Kylie Minogue

Kylie Minogue nuk është vetëm një femër e bukur, por, gjithashtu është edhe një artiste e talentuar dhe e suksesshme. Cilat që i [illegible] gjatë karrierës së saj e vërtetojnë këtë.
Ja kujtohet kënga "I should be so lucky". Kjo ishte një nga të parat që ajo i këndoi. Gjithashtu Kylie ka dhënë versionin më të njohur të këngës "Little Eva's Locomotion". Këngët e saj të fundit janë "Put Yourself In My Place", "Confide In Me", "Some Kind Of Bliss" dhe kënga "Did it Again". Albumi i ri i saj sapo ka dalë dhe është i mrekullueshëm!
Në karrierën e saj si aktore përfshihen filmat "The Delinquents", "Fighter 2" dhe "Biodome".

**Në kafe-galerinë "Vizioni i studentëve", të hënën u mbajt një ekspozitë e dy artistëve mitrovicas**

# Tema kryesore - aktualiteti në Mitrovicë

## Karakteristikë e ekspozitës - përdorimi i gazetës në veprat artistike të këtyre të rinjve



Gani Sadiku "Perspektiva"

PRISHTINË, 9 MAJ - Në "Vizionin e Studentëve", para disa ditëve u mbajt ekspozita e dy artistëve mitrovicas.

Gani Sadiku më 1998 ka përfunduar studimet posdiplomike në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ndërsa Tafil Peci Fakultetin e Arteve, Dega e Grafikës, e përfundoi më 1997. Që të dy këta artistë figurativë janë anëtarë të Shoqatës së Artistëve të Kosovës.

"Jam munduar që të prek aktualitetin në Kosovë", theksoi Gani Sadiku, në punimet e të cilit vërehet si karakteristikë përdorimi i gazetës. "Gazetën e kam përdorur si shprehje figurative dhe si harmoni me ngjyra".

Në punimet e Sadikut gjithashtu vërehej edhe tema e së kaluarës, vuatja dhe shpresa, si elemente më kryesore.

"Në punimet e mia paraqiten vuajtjet, por edhe shpresa për të ardhmen", theksoi ai. "Për mua nuk është e rëndësishme se çfarë materiali përdoret, me rëndësi është realizimi i idesë".

Grafikat si "Klithma", ku paraqitet njeriu i cili përpiqet të dalë nga një rreth i zi, apo "Skena" ku paraqitet deportimi i refugjatëve, janë kryesisht të punuara në teknikën akuatintë apo gjilpërë e thatë, që paraqesin punën e pandalshme të Tafil Pecit.

"Veprat e mia janë qyteti im", u shpreh Tafil Peci. "Kryesisht dominon e zeza dhe e hirta në kombinim me të kuqen, ku paraqitet aktualiteti në Mitrovicë. Gjithashtu, paraqiten edhe vijat me gjemba, të cilat janë të mbuluara me të bardhë, figurë kjo e cila simbolizon shpresën".

*A.M.*



Tafil Peci "Skena"

Krastës, sivjet më së tepërmi të rinj për audicion janë paraqitur nga Gjakova. "Kemi një prezencë të madhe nga Gjakova, çka tregon se Flaka Krelani, finaliste e edicionit

paraqohet me vetveten. Do të jetë një konkurrim spartan. Unë mendoj që këtë vit, ai që do të dalë prej etheve si 30 finalistët e deritashëm, do të jetë në gjendje ta hapë rrugën e vet drejt famës: ajo që ne e qua-

Në edicionin e parë të "Etheve..." fitoi Anjeza Shahini, e cila prezantoi Shqipërinë për herë të parë në garën evropiane të këngës "Eurovision" dhe u rendit në vendin e shtatë.

Edhe fituesi i edicionit të dytë, Luiz Ejlli, po ashtu pas fitores në këtë garë të talenteve, mori pjesë në "Eurovision". Në finalen e "Etheve..." ishin edhe treshja kosovare: Teuta

Kurti, Rona Nishliu dhe Vesa Luma. Sot rreth 30 finalistë të kësaj gare, janë emra të njohur të muzikës, të cilët pas suksesit në "Ethe...", vazhduan karrierën muzikore.

Tafil Peci e fitoi vendin e pa[illegible] në një garë të piktures në Korçë

# Piktori mitrovicas fiton garën ballkanike

**Në një garë, në të cilën morëm pjesë piktorë nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia dhe nga Kosova, piktori mitrovicas Tafil Peci e mori çmimin e parë me një pikturë të kryqit si simbol fetar, me idenë për të paraqitur pamjet magjepse të rrethinës dhe të qytetit të Korçës me një qasje moderne**

AHMET JASHARI



**Mitrovicë, 4 nëntor** - Piktori mitrovicas Tafil Peci e ka fituar çmimin e parë në Javën e Konkursit Ndërkombëtar të Pikturës, që është mbajtur javën e kaluar në Korçë të Shqipërisë. Në këtë garë, në të cilën morëm pjesë, përveç piktorëve nga Shqipëria, edhe piktorë të ftuar nga vendet fqinjë, si Greqia, Maqedonia dhe nga Kosova, Peci mori çmimin e parë me një pikturë të kryqit si simbol fetar, me idenë për të paraqitur pamjet magjepse të rrethinës dhe të qytetit të Korçës me një qasje moderne. Arritja kryesore ka qenë guximi i vendosjeve të tri punimeve në formë të kryqit, duke dalë nga rregullat tradicionale përbrenda tablos. Përderisa Peci mori vendin e parë, të dytin e arriti piktorja shqiptare Xheneta Kadillari, kurse të tretin piktori grek nga Athina, Qirjakos Ricos. Për çmimin e parë Peci mori 1 500 euro, të cilat atij ia ndau kryetari i Bashkisë së Korçës, Nik Palesi. Piktori mitrovicas tha se ky çmim është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për të, por edhe Mitrovicën e Kosovën, duke pas parasysh një konkurrencë jashtëzakonisht të fortë, si dhe jurinë profesionale ndërkombëtare. "Ka rëndësi të madhe edhe për faktin se po e marr çmimin në qytetin me të cilin Mitrovica është e binjakëzuar. Për këtë arsye, punimin ia kam dhuruar qytetit të Korçës. Kjo më jep motiv që ta vazhdoj punën e mëtutjeshme", tha Peci. Sipas tij, është me rëndësi që të vazhdojë bashkëpunimi me qytetin e Korçës dhe në këtë kontekst Ministria e Kulturës dhe komunat e Kosovës duhet të bëjnë më shumë në krijimin e kushteve për artisët e rinj, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë në aktivitet e ndryshme ndërkombëtare. Ndryshe, në këtë festival ku janë ekspozuar 80 piktura, kosovari nga Mitrovica është dalluar me stil të veçantë, me thyerje të kompozicioneve dhe me një guxim të prezantimit të simboleve fetare.

## LAJME

### Zbulohet Tempulli i Artemidës

[illegible]

### Ekspozitë e Rifatie Bllacës

[illegible]

Zgjidhet fituesi i konkursit mbarëkombëtar të pikturës, "Vangjush Mio"

# Tafil Peçi merr çmimin e tretë



**Korçë, 22 dhjetor** - Konkursi mbarëkombëtar që mban emrin e peizazhistit më të njohur të qytetit të Korçës, Vangjush Mio, ka nxjerrë edhe këtë vit piktorët fitues të këtij evenimenti artistik, i cili është kthyer në një traditë për qytetin e Korçës. Në edicionin e sivjetshëm të konkursit morën pjesë 55 krijues të artit figurativ jo vetëm nga Qarku i Korçës, por edhe qytete të tjera të Shqipërisë. Mes pjesëmarrësve kanë qenë edhe piktorë nga Kosova dhe Mali i Zi. Krijimet e secilit prej tyre u shfaqën në një ekspozitë të përbashkët. Juria vlerësoi me çmimin e parë të konkursit "Vangjush Mio" piktoren shkodrane, Ikbale Kalaja. Dy çmime të dyta u ndanë mes artistëve korçarë, Vladimir Kaçaku dhe Vladimir Topi. Çmimin e tretë të këtij konkursi e fitoi piktori kosovar, Tafil Peçi, një pjesëmarrës i rregullt edhe i kolonisë së piktorëve të quajtur "Ditët e Mios". Ekspozita me punimet e konkursit do të qëndrojë e hapur për disa ditë në qendrën kulturore që mban emrin "Vangjush Mio".

Albanologët përkujtuan historianin Flamur Hadri në 10-vjetorin e vdekjes

# Historiani që me shkencë u kundërvihej politikave antishqiptare

## Në 10-vjetorin e vdekjes tragjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, për studiuesin Flamur Hadri ka ndarë mirënjohjen Post Mortum për kontributin e veçantë që ka dhënë në fushën e studimeve albanologjike

**Prishtinë, 22 dhjetor** - Dega e Historisë e Institutit ...

... fjalën e tij, tha se Flamur Hadri në memorien shkencore ...

e Izraelit për t'i lejuar rindërtimet në këtë territor. Kjo akuzë

Izraeli e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare duke ndërmarrë

Izraeli kanë ... kamionë me material ndërtimor

... ime e ka fajësuar Hamasin.

të kandidaturës së ...





Zgjidhet fituesi i konkursit mbarëkombëtar të pikturës, "Vangjush Mio"

# Tafil Peçi merr çmimin e tretë



**Korçë, 22 dhjetor** - Konkursi mbarëkombëtar që mban emrin e peizazhistit më të njohur të qytetit të Korçës, Vangjush Mio, ka nxjerrë edhe këtë vit piktorët fitues të këtij evenimenti artistik, i cili është kthyer në një traditë për qytetin e Korçës. Në edicionin e sivjetshëm të konkursit morën pjesë 55 krijues të artit figurativ jo vetëm nga Qarku i Korçës, por edhe qytete të tjera të Shqipërisë. Mes pjesëmarrësve kanë qenë edhe piktorë nga Kosova dhe Mali i Zi. Krijimet e secilit prej tyre u shfaqën në një ekspozitë të përbashkët. Juria vlerësoi me çmimin e parë të konkursit "Vangjush Mio" piktoren shkodrane, Ikbale Kalaja. Dy çmime të dyta u ndanë mes artistëve korçarë, Vladimir Kaçaku dhe Vladimir Topi. Çmimin e tretë të këtij konkursi e fitoi piktori kosovar, Tafil Peçi, një pjesëmarrës i rregullt edhe i kolonisë së piktorëve të quajtur "Ditët e Mios". Ekspozita me punimet e konkursit do të qëndrojë e hapur për disa ditë në qendrën kulturore që mban emrin "Vangjush Mio".

Albanologët përkujtuan historianin Flamur Hadri në 10-vjetorin e vdekjes

# Historiani që me shkencë u kundërvihej politikave antishqiptare

**Në 10-vjetorin e vdekjes tragjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, për studiuesin Flamur Hadri ka ndarë mirënjohjen Post Mortum për kontributin e veçantë që ka dhënë në fushën e studimeve albanologjike**

**Prishtinë, 22 dhjetor** - Dega e Historisë e Institutit ...

fjalën e tij, tha se Flamur Hadri në memorien shkencore

## Tafil Peci e fitoi vendin e parë në një garë të pikturës në Korçë

# Piktori mitrovicas fiton garën ballkanike

**Në një garë, në të cilën morëm pjesë piktorë nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia dhe nga Kosova, piktori mitrovicas Tafil Peci e mori çmimin e parë me një pikturë të kryqit si simbol fetar, me idenë për të paraqitur pamjet magjepse të rrethinës dhe të qytetit të Korçës me një qasje moderne**

AHMET JASHARI

**Mitrovicë, 4 nëntor** - Piktori mitrovicas Tafil Peci e ka fituar çmimin e parë në Javën e Konkursit Ndërkombëtar të Pikturës, që është mbajtur javën e kaluar në Korçë të Shqipërisë. Në këtë garë, në të cilën morëm pjesë, përveç piktorëve nga Shqipëria, edhe piktorë të ftuar nga vendet fqinjë, si Greqia, Maqedonia dhe nga Kosova, Peci mori çmimin e parë me një pikturë të kryqit si simbol fetar, me idenë për të paraqitur pamjet magjepse të rrethinës dhe të qytetit të Korçës me një qasje moderne. Arritja kryesore ka qenë guximi i vendosjeve të tri punimeve në formë të kryqit, duke dalë nga rregullat tradicionale përbrenda tablos. Përderisa Peci mori vendin e parë, të dytin e arriti piktorja shqiptare Xheneta Kadillari, kurse të tretin piktori grek nga Athina, Qirjakos Ricos. Për çmimin e parë Peci mori 1 500 euro, të cilat atij ia ndau kryetari i Bashkisë së Korçës, Nik Palesi. Piktori mitrovicas tha se ky çmim është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për të, por edhe Mitrovicën e Kosovën, duke pas parasysh një konkurrencë jashtëzakonisht të fortë, si dhe jurinë profesionale ndërkombëtare. "Ka rëndësi të madhe edhe për faktin se po e marr çmimin në qytetin me të cilin Mitrovica është e binjakëzuar. Për këtë arsye, punimin ia kam dhuruar qytetit të Korçës. Kjo më jep motiv që ta vazhdoj punën e mëtutjeshme", tha Peci. Sipas tij, është me rëndësi që të vazhdojë bashkëpunimi me qytetin e Korçës dhe në këtë kontekst Ministria e Kulturës dhe komunat e Kosovës duhet të bëjnë më shumë në krijimin e kushteve për artisët e rinj, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë në aktivitet e ndryshme ndërkombëtare. Ndryshe, në këtë festival ku janë ekspozuar 80 piktura, kosovari nga Mitrovica është dalluar me stil të veçantë, me thyerje të kompozicioneve dhe me një guxim të prezantimit të simboleve fetare.



## LAJME

### Zbulohet Tempulli i Artemidës

**Athinë, 4 nëntor** - Arkeologët zvicerane dhe grekë kanë zbuluar këtyre ditëve një ndër tempujt më të mëdhenj të antikitetit në Greqi, Tempullin e Artemidës, njoftojnë agjencitë greke të lajmeve. Zbulimi është bërë në ishullin e dytë grek për nga madhësia, Eube. I njohur si "Artemis Amarysia", tempulli i lashtë ndodhej vetëm 10 kilometra larg qytezës së quajtur Eritrea. Për zbulimin e tij, arkeologët kanë punuar për gati dhjetë vjet. Zyrtarët grekë thonë se ky është njëri nga zbulimet më të rëndësishme në Greqinë e kohëve të sotme.

### Ekspozitë e Rifadie Bllacës

**Prishtinë, 4 nëntor** - Më 5 nëntor, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, në kompleksin "Qafa", në Prishtinë, në orën 19.00, hapet ekspozita e piktores së re, Rifadie Bllaca. Autorja i ka mbaruar studimet e pikturës në vitin 2005 në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, në klasat e piktorëve Agron Bytyçi dhe Esat Valla, ku i ka mbaruar edhe postdiplomike. Deri më tash ka marrë pjesë në 11 ekspozita kolektive: Prishtinë, Tiranë, Podujevë dhe Ferizaj. *(n. b.)*

"LAJM"

www. mitrovica - komuna.org
Bekë Abazi 044- 166- 105

të Hasit. Kjo figurë poliedrike na la mbi 75 vepra duke filluar nga "Kanuni i Lekë Dukagjinit" (e mblodhi dhe e kodifikoi Gjeçovi), "Agimi i Gjydetnis", "Trashegime thrrako-ilirijane" e shumë të tjera, prej të cilave deri më tash i janë botuar rreth 25 sosh. /(b. s.)

SUKSESE TË ARTISTËVE TË MITROVICËS

# TAFIL PEÇI, ÇMIMI I PARË NË KONKURSIN NDËRKOMBËTARË PËR PIKTURË

***Tafil Peci është paraqitur me tri vepra, përkatësisht me një triptik, me simbolin fetar-kryqin. Kritikët kanë vlerësuar se arritja kryesore e tij ka qenë guximi i vendosjeve të tri punimeve në formë të kryqit, duke dal nga rregullat tradicionale përbrenda tablosë. Në ndarjen e çmimeve kanë marrë pjesë piktorë, artistë, dashamirës të artit si dhe përfaqësues të pushtetit lokal dhe atij qendror.***

*Mitrovicë, 2 nëntor*

Piktori, tashmë i mirënjohur mitrovicas, Tafil Peci, është kthyer si fitues i çmimit të parë nga Korça, ku kishte marrë pjesë në Konkursin Ndërkombëtar të Pikturës që është mbajtur në pallatin e Kulturës "Vangjush Mio" në qytetin e Korçës, nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë së Korçës, z. Niko Peleshi. Në këtë eveniment kulturor, ku kanë marrë pjesë piktorë nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia dhe nga Kosova, kryesisht janë ekspozuar 80 piktura, ku të gjithë i janë përmbajtur peizazhit, ndërsa piktori nga Mitrovica e ka parë ndryshe nga të tjerët qytetin e Mios, duke u dalluar me një stilit ë veçantë, me thyerje të kompozicioneve dhe me një guxim të prezentimit të simboleve fetare. Juria në përbërje Pande Petrovski (Nga Maqedonia), Linda Tsilaga (nga Greqia)dhe Vlladimir Topi (nga Shqipëria), ka shpall tre fitues: në vendin e tretë piktori grek nga Athina Qirjakos Ricos, në të dytin piktorja shqiptare Xheneta Kadillari dhe në vendin e parë piktori i njohur mitrovicas Tafik Peci. Pas kthimit në Mitrovicë, piktori Peci është pritur nga kryeshefi i ekzekutivit Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Sadri Ferati, i cili e ka përgëzuar për suksesin e arritur dhe e ka inkurajuar për të vazhduar punën drejtë sukseseve dhe më të mëdha në të ardhmen, si dhe u ka premtuar ndihmë artistëve mitrovicas për të shkuar rrugës së sukseseve nëpër evenimente të ndryshme kukturore. Peci ka thënë se mes teknikave dominonte vaji, akuareli dhe dizenjoja, si dhe ka njoftuar se ekspozita do të qëndrojë e hapur për dy javë rresht për dashamirësit e artit viziv dhe se ajo përcjell nga mës e tetë TV të njohura nga Shqipëria dhe një numër i madh i gazetarëve. "Çmimi që më është ndarë, është një çmim shumë i rëndësishëm, besoj se jo vetëm për mua, por edhe për Mitrovicën e më gjerë, sepse ai është fituar në një konkurrencë jashtëzakonisht të madhe dhe është vlerësuar nga një juri kompetente profesionale ndërkombëtare", ka thënë Peci. Ai ka shtuar se çmimi ka rëndësi të madhe edhe për faktin se është fituar në qytetin e Korçës, me të cilin Mitrovica është e binjakëzuar. "Për këtë arsye, punimin ai kam dhuruar qytetit të Korçës. Kjo më jep motiv që të vazhdojë punën e mëtutjeshme dhe të vazhdoj bashkëpunimin e ndërsjellë me qytetin e Korçës", është shprehur Peci. Ai në vazhdim ka thënë se Ministria e Kulturës dhe komunat e Kosovës, duhet të bëjnë më shumë për krijimin e kushteve për artisët të rinj, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë në aktivitet e ndryshme ndërkombëtare, sepse vërtetë ka talent dhe ata mund të depërtojnë në arenën ndërkombëtare dhe ta prezentojnë në mënyrë dinjitoze Kosovën, për çka ka shumë nevojë në këto momente. Tafil Peci ka organizuar deri tash shtatë ekspozita personale, katra në Mitrovicë, një në Prishtinë dhe dy në Francë, njërën në Paris dhe tjetrën në Vicene të Francës, ku ishte i ftuar nga kryetari i komunës. Ai ka marrë pjesë në më se 80 ekspozita kolektive në vend dhe jashtë vendit, ka fituar dy çmime dhe ky ishte i treti. Për momentin udhëheq Shoqatën e Artistëve Figurativ të Mitrovicës. Është anëtar i Shoqatës të Artistëve Figurativ të Kosovës. Në fund, piktori i talentuar Tafil Peci, ka falënderuar qytetin e Korçës për mikpritje të jashtëzakonshme dhe respektin e treguar ndaj tij dhe Kuvendin e Komunës të Mitrovicës, që e ka ndihmuar për të marrë pjesë në këtë eveniment të rëndësishëm kulturor ndërkombëtar. /*Hysni Syla*

SOT NË TEATRIN KOMBËTAR

# SHFAQET FILMI DOKUMENTAR "DITURIA E FSHEHTË"

Të shtunën në mbrëmje në Teatrin Kombëtar shfaqet premiera e filmit dokumentar "Dituria e Fshehtë", i prodhimit gjerman. Për filmin thuhet se "ka arritur sukses dhe diskutime nëpër Evropë në edukimin dhe ndryshimin e mendjes së njeriut, i cili paraqet një histori të fshehtë me shekuj, se po të mos ishin konfliktet në mes kulturave, njerëzit do të pranonin më lehtë njëri tjetrin në botën e qytetëruar." Filmi shfaqet prej orës 19 në Teatrin Kombëtar në Prishtinë. /(s. s. m.)

Fest
në 1
më
edh
festi
ten
Gjer

"Prisht
veçant
kës. M
takon a
një niv
qëndro
serioze.
gjithsej
prezent
vende t
Italia, G
bendet i
kjo jo ra
festivali
munguar
kosovar
haz etj,
problemi
të thuhet
xhazmuz
katër fest
zit (dy në
i katërt ni
mirë për
marrë për
është përv
"Prishtina
bendet e S

# ANE ENRIGHT I DORËZOHET 'MAN BOKER PRIZE'

Romancieres Ane Enright i është dorëzuar dje çmimi i njohur në letërsi, "Man Boker Prize". Ane Enright mori çmimin, me vlerë 100 mijë dollarë, për veprën e saj "The Gathering". Ajo kishte kohë që priste ta marrte këtë çmim, i cili jepet për romanin më të mirë të vitit në Britani, Irlandë apo vendet e Komonuelthit. E teksa ngjarjet në romanin e saj zhvillohen në Irlandë, shkrimtarja nuk preferon që të shihet thjesht si shkrimtare irlandeze. "Irlanda vetë është plot me ide të fuqishme dhe kjo nuk përfshin domosdoshmërish një person si unë. Ka nostalgji për një Irlandë që është katolike. Unë nuk jam në mënyrë të veçantë katolike, gjë që shpesh herë është rurale. Unë jam urbane, gjithmonë kam qenë vajzë moderne dhe Irlanda vetëm kohët e fundit është duke u bërë moderne", u shpreh Anne Enright, kur mësoi se ishte më në fund fituesja e "Man Boker Prize".

# NISI 'JAVA E KULTURËS

## ÇASTE ME PIKTORIN MITROVICAS, TAFIL PECI

# MË E MIRA NË MESIN E 80 PIKTURAVE

Ditë më parë, në pallatin e kulturës "Vangjush Mio" në qytetin e Korçës, u mbyll java e Konkursit Ndërkombëtar të Pikturës. Në këtë konkurs morën pjesë, përveç piktorëve nga Shqipëria edhe piktorë të ftuar nga vendet fqinjë, si Greqia, Maqedonia dhe Kosova. Kolonia e piktorëve në këtë konkurs duhej të punonte në peizazhin, që do të fitonte çmimin që mban emrin e piktorit adhurues të peizazhit, Vangjush Mio. Në këtë garë para jurisë vlerësuese: Pande Petrovski - Maqedoni, Linda Tsilaga - Greqi dhe Vlladimir Topi - Shqipëri, mitrovicasi Tafil Peci u paraqit me tri vepra. Ai paraqiti një triptik me një simbol fetar. Piktori kosovar Peci me këtë pikturë paraqiti pamjet magjepse të rrethinës dhe të qytetit të Korçës, të shprehura ato në mënyrë moderne. Juria e përbërë prej tre vetash shpalli fitues nga tre vende dhe përkatësisht në vendin e tretë piktori grek nga Athina Qirjakos Ricos, në të dytin piktorja shqiptare Xheneta Kadillari



Në Konkursin Ndërkombëtar të Pikturës në Korçë piktori mitrovicas, Tafil Peci fitoi çmimin e parë "Mio", që jepet për nder të piktorit adhurues të peizazhit, Vangjush Mio

cioni ndërkombëtar. Çmimi "Mio", përpos që ka rëndësinë e vet në botën e piktorëve, ai ka vlerën prej 1.150 eurove. Në këtë ekspozitë ...

me një guxim të prezantimit të simboleve fetare, kanë vlerësuar anëtarët e jurisë. Tafil Peci ka hapur deri tash ...

Artistëve Figurativ të Kosovës.

I pyetur rreth çmimit të fundit, Peci ka theksuar se për mua është një çmim shumë i rëndësishëm, jo vetëm për mua si piktor, por edhe për Mitrovicën e Kosovën, duke pas parasysh një konkurrencë jashtëzakonisht të madhe dhe jurinë profesionale ndërkombëtare. "Ka rëndësi të madhe se vlerësohem nga Korça me të cilin Mitrovica është e binjakëzuar. Për këtë arsye punimin ia kam dhuruar qytetit të Korçës", thotë Peci dhe shton se do të vazhdojë bashkëpunimin e ndërsjellë me qytetin e Korçës. Piktori mitrovicas mendon se Ministria e Kulturës dhe komunat duhet të bëjnë më shumë në krijimin e kushteve për artisët të rinj, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë në aktivitet e ndryshme ndërkombëtare, sepse vërtet ka talente dhe ata mund të depërtojnë në arenën ndërkombëtare dhe ta prezantojnë artin kosovar në mënyrë dinjitoze. Duke përfunduar, Peci ka

# Ekspozitë retrospektive e miqve nga Mitrovica



Nën kujdesin e Bashkisë Korçë dhe Qendrës "Mio" miqtë nga Mitrovica, Tafil Peci dhe Besnik Hasanaj, çelën ekspozitën me grafika dhe fotografi. Në fjalën e hapjes drejtori i Qëndrës,Vladimir Topi, theksoi se është nder që dy miqtë vijnë në Korçë dhe sjellin për artdashësit e arteve vizive këtë ekspozitë. Peci vjet fitoi konkursin "Mio" dhe sivjet vjen me një vepër të plotë dhe dinjitoze. Në këtë ekspozitë-vazhdoi Topi -autori shfaqet me mjaft profesionalizëm në grafikat e tij bashkë me punët edhe të fotografit Hasanajt. Kryebashkjaku Peleshi uroi mirëseardhjen e Kryetarit të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Rexhepi, dhe të artistëve. Tafili, -u shpreh Peleshi, -është pjesë e Kolonisë së piktorëve që çdo vit do të vijnë në qytetin tonë për të na dhuruar peisazhe të mrekullueshme. Por ka edhe një motiv tjetër, qytetet janë në lidhje të ngushta mes tyre, udhë që ka nisur dhe vazhdon përmes binjakëzimit, me qëllim që të nxjerrin në pah vlerat shpirtërore të dy qyteteve tona. Sivjet Kosova vjen me një pashaportë të re, atë të Pavarësisë dhe do synohet që bashkëpunimi të shtrihet edhe në fusha të tjera. Më pas fjalën e mori Kryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Bajram Rexhepi, që u shpreh se ishte i nderuar që ndodhet mes vëllezërve korçarë. Është hera e parë që ndodhet në Korçë për t'u ndalur më gjatë, pasi kur ishte kryeministër i Kosovës nuk kishte pasur rast që të takohej me qytetin. Ishte i nderuar edhe për faktin që kishte ardhur me dy artistë, por u ndje i befasuar për praninë edhe të një fotografi mitrovicar. Korça, -vazhdoi Rexhepi, -ka qënë djepi i diturisë dhe i kulturës dhe besojmë se do të gjejmë edhe hapësira për bashkëpunim edhe në fusha të tjera. Integrimet janë të natyrshme dhe në vazhdë e sipër. Të dy artistët për Nositin shprehën kënaqësinë që ndodhen në Korçë: Peci në këtë vit, pas çmimit të parë në Korçë, ka pasur një axhendë të pasur si në Kosovë, ku fitoi një çmim, 4 javë pas çmimit të Korçës. Ka hapur ekspozita në Bullgari, Amerikë dhe është i angazhuar në mjaft ekspozita të tjera ndërkombëtare. Besniku u shpreh se e ka menduar ndryshe qytetin, në kujtime, si qytet të vjetër dhe të lashtë. Na u bë një pritje madhështore dhe shpresoj të mos ju zhgënjejmë. Kam sjellë, -vazhdoi, -përmes fotografive informacione për Mitrovicën dhe rrethinat e tij. Kam sjellë në fokus Mitrovicën e pasluftës dhe deri në ditët tona. Është pozitiv fakti që ka shkëmbime kulturore mes dy qyteteve tona.

Më pas të pranishmit vizituan ekspozitën dhe falënderuan miqtë për këtë dhuratë të shkëlqyer që edhe korçarët të njohin historinë e Mitrovicës dhe vlerësuan punimet e dy artistëve kosovarë. Ndërsa drejtori i Qëndrës "Mio", Topi, shprehet entuziast për këtë bum aktivitetesh që synojnë të nxjerrin në pah vlerat e artistëve shqiptarë, por edhe të huaj që kanë ardhur dhe do të vijnë në Korçë. Së shpejti do të organizohet edhe Simpoziumi Ndërkombëtar i Skulpturës "Parku Korçë 2008", ku do të marrin pjesë 8 skulptorë nga vendi, Europa dhe më gjërë, nismë që do të ketë mbështetjen e institucioneve lokale.

**Arjan Kallço**



# Java europiane në Korçë

Në kuadrin e Javës Europiane 2008 në Shqipëri, në amfiteatrin e Universitetit "F.S.Noli", u zhvillua, më datën 7 maj, një takim ku morën pjesë pedagogë dhe studentë të këtij universiteti. Ndodheshin dhe përfaqësuesi i Këshillit të Europës, Ambasadori i Greqisë në Tiranë, Kostandin Kokosis dhe Aldo Bumçi, deputet i Parlamentit Shqiptar. Në fjalën e hapjes prefektja Zefi falënderoi delegacionin që ndodhet në Korçë dhe foli për rëndësinë e kësaj jave që ka për Shqipërinë, e cila kërkon anëtarësinë në Europë.

Ambasadori i Greqisë theksoi se futja është më shumë teknike dhe ekonomike sesa politike. Ka disa kritere për t'u anëtarësuar: politike, ekonomike, sociale dhe aftësia e Europës për të thithur anëtarë të rinj. Diplomacitë e perëndimore janë në një zë kur bëhet fjalë për pranimin e vendeve të rinj në gjirin e Europës. Për Ballkanin Perëndimor-vazhdoi ambasdori grek, ka edhe dy marrëveshje të viteve 1993 dhe 2005. Roli i Këshillit të Europës luan rol të veçantë në këtë integrim me kërkesat që parashtrohen para vendeve që aspirojnë integrimin: kontrolli, monitorimi, ndihma për të realizuar këto kërkesa. Më pas e mori fjalën deputeti Bumçi, i cili u ndal në projektin Bashkimi Europian, si një projekt ku argumentat, për të cilat mund të flitet janë të shumta. Dy janë momentet më të rëndësishme të këtij projekti: formimi i tij ngaideja e deri në vitin 1990 dhe transformimi i tij pas viteve 1990 në të gjithë kontinentin Europian.

Fillimi i viteve '90 e gjeti Europën pa një projekt për pjesën lindore, por u synua që të zgjerohej më anëtarë të rinj duke futur vendet më të zhvilluara të lindjes si Çekia, Hungaria, Polonia. Futja më vonë e Rumanisë dhe Bullgarisë ishte më shumë një akt politik i Europës. Rektori i Universitetit "Noli", Gjergji Mero, falënderoi Këshillin e Europës që zgjodhi sallën e Universitetit të Korçës për këtë takim dhe theksoi se integrimi i Shqipërisë në Familjen Europiane kalon nëpër universitetet shqiptare dhe përfshirja edhe e tyre në projektet e atyre europiane do ta bëjë të mundur këtë integrim.

**A.K**